

URDHËR
Nr. 189, datë 1.4.2019

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino, të ndjekë dhe të nënshkruajë çështjet që kanë të bëjnë me:

- a) hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- b) hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- c) ndjekjen, monitorimin dhe konfirmimin e regjistrimeve të diplomave të ciklit të tretë në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë;
- d) regjistrimin, monitorimin dhe konfirmimin e njohjes dhe njësimit të diplomave të ciklit të tretë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë;
- e) kryesimin dhe monitorimin e veprimtarisë së grupeve të punës për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- f) përmbushjen e objektivave të parashikuara në Planin 300-ditor të Qeverisë, për pjesën që i përket arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- g) koordinimin me agjencitë dhe bordet përkatëse të administrimit, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që mbulojnë fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- h) koordinimin me subjektet institucionale që operojnë në fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- i) nënshkrimin e urdhrave për miratimin e statuteve apo ndryshimeve statutores të institucioneve të arsimit të lartë;
- j) monitorimin në vazhdimësi të zbatimit të standardeve dhe kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- k) drejtimin e komisionit për përzgjedhjen e studentëve të shkëlqyer të cilët do të ndjekin studimet e ciklit të parë, të dytë dhe studimet e doktoratës dhe drejtimin e komisionit për përzgjedhjen e nëpunësve civilë të administratës shtetërore që do të ndjekin një program 1-vjeçar, master të ciklit të dytë apo të tretë;
- l) kryesimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- m) koordinimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me partnerët;
- n) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave të ministrit, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe agjencive të varësisë, për çështjet në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve pune nga miratimi i këtij urdhri të detajojë planin e tij të punës. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri për veprimtarinë javore të kryer i raporton me shkrim ministrit çdo të hënë tëjavës pasardhëse.

5. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me kabinetin e ministrit dhe me drejtoritë që mbulojnë fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

6. Ngarkohet stafi administrativ i ministrisë dhe institucionet e varësisë, që të asistojnë dhe mbështesin zëvendësministrin, në përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

7. Ngarkohet zëvendësministri, z. Redi Shtino, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini